



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159, Email: iber\_lepenci@hotmail.com

## ***REGULLORE PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME***

**PRISHTINË, Tetor 2011**

Me qëllim të implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Ligjit për tatim në të ardhura të korporatave (Ligji Nr. 03/L-162), Ligjit për shoqëritë tregtare (Ligji Nr. 02/L-123), Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji Nr. 03/L-087), Ligjit për menaxhimin e financave publike (Ligji Nr. 03/L-048), NH "Ibër-Lepenc" sh.a. aprovon këtë:

## **Rregullore për provizionimin e llogarive të arkëtueshme**

Departamenti financiar në kuadër të NH "Ibër Lepenc" Sh.a. është përgjegjës për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si dhe të gjitha procedurave dhe politikave kontabël të aprovuara nga ndërmarrja.

Përmes kësaj Rregullorje, Ndërmarrja do të ketë një politikë të shlyerjes në lidhje me kalkulimin e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe një kontrollë më të mirë ndaj kërkesave. Ndërmarrja do të bëjë analiza të rregullta të vjetërsisë së llogarive të akëtueshme. Kjo do të ndihmojë menaxhmentit që të përmirësoj arkëtimet dhe barazimet me klientet dhe të bëjë vlerësime të sakta për provizione të borxheve të këqija.

### **I Shpenzimet për Borxhet e Këqija**

#### **Neni 1**

Regjistrimet akruale bëhen për të pasur mundësi në parashikimin e të hyrave nga shitjet, lejimet për shitje si dhe zbritjet që i takojnë shitjeve tanimë të konsumuara që nga data e raporteve financiare.

#### **Neni 2**

Harmonizimi i duhur mund të arrihet vetëm nëse shpenzimi për borxhet e këqija është i regjistruar në periodën e njëjtë fiskale me të hyrat ndaj të cilave kanë lidhshmëri. Nëse ky shpenzim mund të njihet me saktësi atëherë do të bëhet provizionimi. Duke pasur parasysh klientët e ndërmarrjes "Ibër Lepenc" është e mundur të kalkulohet vjetërsia korrekte e llogarive të arkëtueshme.

#### **Neni 3**

Provizionimi do të bëhet në ngarkesë të shpenzimeve për borxhet e këqija dhe lejimeve për borxhe.

*Debi: Shpenzimet për borxhet e këqija*  
*Kredi: Lejimet për borxhe*



#### Neni 4

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të analizohen çdo muaj nga shërbimi i financave, për të filluar veprimet e nevojshme për mbledhjen e borxheve, derisa në baza vjetore kalkulohet provizionimi për llogaritë e arkëtueshme të vlerësuara si të dyshimta dhe si borxhe. Vlera e llogarive të arkëtueshme në bilancin e gjendjes do të tregohet pas heqjes së lejimeve për llogari të arkëtueshme.

## II Borxhi i Keq

#### Neni 5

Një borxh i keq do të konsiderohet shpenzim nëse:

- 5.1 Shuma që korrespondon me borxhin, më përpara është përfshirë në të hyra;
- 5.2 Kanë kaluar së paku 6 muaj nga afati i pagesës;
- 5.3 Nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;
- 5.4 Borxhi është çregjistruar në libra si i padobishëm për qëllime kontabiliteti; dhe
- 5.5 Ka evidencë te mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit, sikurse janë:
  - 5.5.1 Barazimi i çdo borxhi të pakontestueshem kundrejtë borxhit të keq,
  - 5.5.2 Korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për mbledhjen e borxhit,
  - 5.5.3 Veprimi juridik ka qenë i pasuksesshëm, apo është konsideruar si joekonomik për arsye të dokumentuara.

#### Neni 6

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të rishikohen në fund të çdo viti financiar për të siguruar se borxhet e dyshimta janë kontabilizuar në mënyrë adekuate.

#### Neni 7

Autoritetin për shlyerjen e borxheve e tilla e ka Kryeshefi Ekzekutiv ose nën vartësit nëse autorizohen nga Kryeshefi Ekzekutiv .

#### Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas kalimit të shtatë (7) ditëve nga dita e nënshkrimit nga KE dhe publikimit në Ndërmarrje.

**Kryeshefi ekzekutiv:**

**Hajdar Beqa**





N.H.  
V.P. "IBËR-LEPENC" Sh.A  
D.D.

01-3927 Dt. 28. 12. 2012

PRISHTINE - PRISTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina,  
Kosovo Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

**RREGULLORE  
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PROVIZIONIMIN E  
LLOGARIVE TË ARKËTUESHME**

**Prishtinë, Dhjetor 2012**



Në Rregulloren për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, nr. 01-3556 dt. 18.10.2011 kryhet ky plotësim:

#### **Neni 1**

Në faqen 2 të Rregullores së sipërshenuar, në nenin 4, reshti i tretë, në mes të fjalës „borxhe” dhe „pikes (.)” shtohet teksti „derisa llogaritë e arkëtueshme nga Ujitja, mund të provizionohen në baza deri në dy vite”.

#### **Neni 2**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga KE dhe aplikohet duke përfshirë edhe vitin afarist 2011.

#### **Neni 3**

Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e Rregullores bazë nr. 01-3556 dt. 18.10.2011.

**KRYESHEFI EKZEKUTIV**  
*Hajdar Beqa*  
**Hajdar Beqa**